



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJES
KËSHILLI I BASHKISE



V E N D I M

Nr. 04, datë 24.01.2020

Për miratimin e listës së kullotave në pyje të gatshme për kullotje dhe kositje bari.

Këshilli i Bashkise Vau Dejës në mbledhjen e dates 24.01.2020, mbështetur në nenin 9 pika 1.2, nenin 27 pika 5, nenin 54 shkronja “e”, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 17 pika 4 e ligjit nr. 9693/2007 “Për fondin kullosor“ i ndryshuar”, **pika 49** e VKM nr. 433 datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive” Kreu II, pika 2 e Udhëzimit nr. 2, datë 20.7.2016 të Ministrit të Mjedisit “Për kriteret teknikë të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari”, Këshilli pas miratimit me shumice të cilësuar votash :

V E N D O S I

1. Miratimin e listës së kullotave në pyje të gatshme për kullotje e kositje sipas listës dhe hartave bashkëlidhur.
2. Për vazhdimin e procedurave sipas përcaktimeve të udhëzimit nr. nr. 2, datë 20.7.2016 të Ministrit të Mjedisit “Për kriteret teknikë të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari” ngarkohet Sektori Pyjeve dhe Kullotave në Bashki.
3. Vlera e dhenies me qira të jete sipas VKM nr.632 datë 11.6.2009, “Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje dhe kositje”
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.
5. Ky vendim u shpall sot me datën 31.01.2020

SEKRETARI
Ardian Çelepija



KRYETARI
Mark Bisha